



## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

---

### NJOFTIM

#### **PËR RIHAPJEN E PROCEDURËS SË KOMANDIMIT NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË DHE SHPALLJEN E KËRKESËS PËR KANDIDATURA NGA RADHËT E GJYQTARËVE**

**Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 322, datë 17.09.2020, ka vendosur:**

- *Rihapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*
- *Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për gjashtë pozicione të lira si inspektor.*

**Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:**

**Çdo gjyqtar të interesuar, që plotëson kushtet dhe kriteret e komandimit, për të paraqitur kërkesë për komandim.**

**Kohëzgjatja e komandimit, në këto pozicione të shpallura, është deri në 5 (pesë) vjet.**

**Kohëzgjatja e komandimi mund të përfundojë para afatit:**

- a) me kërkesë të gjyqtarit të komanduar, për shkaqe të justifikuara;
- b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit;
- c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore;
- ç) kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen;
- d) kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra.

**Kushtet e përgjithshme të komandimit janë:**

- a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;
- b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
- c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;

- ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë:
  - i) duhet duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
  - ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës.

**Kushtet e veçanta të komandimit janë:**

- a) Kandidati duhet të plotësojë kushtet për emërim në Gjykatën e Lartë, si më poshtë:
  - i) të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;
  - ii) të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
- b) në kohën e kandidimit, të mos jetë kryetar i një gjykate ose anëtar i organeve drejtuese të grupeve të interesit, të tilla si shoqata ose sindikata magjistratësh etj;
- c) të jetë vlerësuar të paktën “shumë mirë” në dy vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale;
- ç) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- d) të mos jetë i dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- dh) në kohën e kandidimit, të mos ketë asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të Ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ose të afërm të shkallës së parë, që punon si inspektor në Zyrën e Inspektorit e Lartë të Drejtësisë.

Plotësimi i kushteve të komandimit do të verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në vendimin e sipërcituar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Në momentin e kandidimit, kandidati duhet të dorëzojë:**

- Një vetëdeklarim se nuk ka asnjë anëtar të familjes, sipas kuptimit të Ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, ose të afërm të shkallës së parë, që punon si inspektor në Zyrën e Inspektorit e Lartë të Drejtësisë.

**Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin shoqërues është është dy javë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të njoftimit për rihapjen e procedurës së komandimit. - Ky afat përfundon më datë 02.10.2020.**

**Dokumentacioni i aplikimit (Kërkesa për komandim dhe Vetëdeklarimi) duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën Rruga “Ana Komnena”, (ish-fusha e aviacionit), Tiranë.**

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me procedurat e kandidimit mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke u konsultuar me Vendimin nr.322, datë 17.09.2020, “Për hapjen e procedurës së komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.**

**Ky njoftim është publikuar më datë 18.09.2020.**